

Ligji 107/2017 date 30.11.2017

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 49, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Përjashtimisht sa përcaktohet në pikën 3, të këtij neni, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 % aplikohet për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”.

Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 107, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë, me vendim, që për ndonjë kategori personash të tatueshëm, periodha tatimore të jetë më e gjatë se një muaj, por jo më e gjatë se një vit kalendarik.”.

Neni 3

Në nenin 109, në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë, me vendim, që për ndonjë kategori personash të tatueshëm, regjistrat përmbledhës që shoqërojnë deklaratën e TVSH-së, të jenë për një periudhë më të gjatë se muaji, por jo më e gjatë se një vit kalendarik.”.

Neni 4

Në nenin 117, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në, rastet e përjashtimit apo kufiri minimal i regjistrimit për kategori të veçanta, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

**K R Y E T A R I
Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 30.11.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10688, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

Botuar ne F.Zyrtare 222/2017

Dale nga shtypi me 19.12.2017